



# Kur fëmijët vijjnë të parët



Radiohjälpen  
90 1950-6

**WE** SWEDISH  
COOPERATIVE  
CENTRE  
**EFFECT**



Ky material është financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect. Radiohjalpen dhe We Effect jo domosdoshmërisht bien dakort me mendimin e shprehur. Vetëm Autori është përgjegjës për përmbajtjen.

Punoi & Redaktoi:

**Marsela Isaku**

Koordinatorë Projekti

**Unioni “Amaro-Drom”**

©Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro-Drom”

Adresa: Rr. Sulejman Pasha,

Lagjia 4, P.2, Shk.3

Telefon/Fax: 00355 4 248925 & 231391

E-mail: amarodrom@abissnet.al

Website: [www.unioniamarodrom.com](http://www.unioniamarodrom.com)

Tiranë, Shqipëri

# Parathënie

Ky botim publikohet në kuadër të projektit "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Romë" financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect, i cili zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom në zonat: Korçë, Shkodër, Moravë-Berat, Baltëz-Fier.

Botimi është në funksion të aktiviteteve të projektit dhe njëkohësisht të çështjeve që lidhen me arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri.

Arsimimi i fëmijëve Rom, është një nga fushat prioritare të Unionit "Amaro-Drom" që në momentet e para të krijimit pasi "Pa arsim nuk ka zhvillim, nuk ka integrim, nuk ka të ardhme".

Një rëndësi e veçantë nga Unioni "Amaro-Drom" i është kushtuar kujdesit të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, ku një sërë projektesh të zbatuara, kanë patur në fokus edukimin parashkollor.

Vitet e hershme të jetës, janë të rëndësishme për zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijës dhe vendosin themelet për fitimin e aftësive që ndikojnë në të ardhmen.

Mirëqënia dhe shëndeti i fëmijëve tanë, është një çështje që na prek të gjithëve dhe të gjithë duhet të jemi pjesë e zgjidhjeve për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjithë aktorët të cilët kontribuojnë për arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri. Dëshiroj të falenderoj për mbështetjen në realizimin e këtij projekti, donatorët, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, drejtuesit e Drejtorive Arsimore Rajonale në Korçë, Shkodër, Fier dhe Berat, Drejtoritë dhe edukatoret e kopshteve të projektit dhe stafin e projektit.

Çdo fëmijë duhet të ndihet i vlerësuar dhe të ketë mundësi të zhvillojë potencialin e tij. Le të përpiqemi të gjithë së bashku t'u ofrojmë fëmijëve tanë një mjedis të sigurt, të ngrohtë dhe gjithpërfshirës.



Sinqerisht,  
**Skënder Veliu**  
Drejtor Ekzekutiv  
Unioni Amaro Drom



# Përmbajtja

|                                                                                                                                                            |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Parathënie .....                                                                                                                                           | 3  |
| Rreth projektit.....                                                                                                                                       | 6  |
| Arritjet e projektit .....                                                                                                                                 | 8  |
| Arsimi gjithpërfshirës .....                                                                                                                               | 10 |
| Konferencë kombëtare në kuadër të 20 nëntorit, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve .....                                                        | 12 |
| Dita Ndërkombëtare e Romëve, 8 prill 2016 .....                                                                                                            | 16 |
| Shkëmbim eksperience midis stafeve edukative në kopshtin në lagjen “Stan” Morave - Berat .....                                                             | 20 |
| Regjistrimit civil, ende një çështje e pazgjidhur për antarët e komunitetit rom .....                                                                      | 22 |
| Tryeza të rumbullakta me ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve në nivel lokal. ...                                                                    | 25 |
| E shoh në sytë e tyre.....                                                                                                                                 | 28 |
| Shkëmbim eksperience midis stafeve edukative në shkollën “Trifon Prifti” Hamil - Fier.. ...                                                                | 30 |
| Ndikimi që kanë aktivitetet kreative dhe lojërat sociale në përshtatjen dhe në procesin e nxënies të fëmijët e grupmoshës 3-4 dhe 5-6 vjeç në kopsht. .... | 32 |
| Rëndësia e kujdesit shëndetësor në fëmijërinë e hershme .....                                                                                              | 35 |



# RRETH PROJEKTIT



**P**rojekti "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Romë" financohet nga Radiohjalpen dhe We Effect, dhe zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom".

Ky projekt zbatohet në Kopshtin "Lulet e vogla" dhe kopshtin numër 10 në Korçë, në Kopshtin e Lagjes "Stan" Moravë- Berat, në kopshtin i cili ndodhet në ambjentet e shkollës "Liria" dhe në "Fshatin e Paqes" në Shkodër dhe në kopshtin e ndodhur brenda ambjenteve të shkollës "Trifon Prifti" Hamil-Fier.

Periudha e zbatimit të projektit është Qershor 2015-Mars 2017 dhe ka për qëllim, përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve Rom dhe fëmijëve të disavantazuar jo-Rom, konkretisht duke adresuar mungesën e mundësive për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, frekuentimin në nivel të ulët të shkollës dhe përjashtimin social.

**Objektivat**

**Aktivitetet**

## Objektivat e projektit janë:

- Përmirësimi i aksesit ndaj shërbimeve cilësore të fëmijërisë së hershme;
- Reduktimi i pabarazisë ekonomike për të patur akses në shërbimet e edukimit parashkollor për fëmijët Rom;
- Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e regjistrimit civil, edukimit të hershëm dhe shëndetit të fëmijëve;
- Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve dhe mentalitetit të prindërve për parandalimin e sëmundjeve;
- Regjistrimi civil, rritja e kapacitetit të antarëve të komunitetit rom për zgjidhjen e rasteve të regjistrimit civil.

## Aktivitetet kryesore të projektit janë:

- Lehtësimi i aksesit dhe regjistrimit të fëmijëve Rom të moshës 3-6 vjec në kopësht dhe të kalimit të fëmijëve 6- vjecar në shkollë;
- Vlerësim nevojash, regjistrim, monitorim dhe vlerësim i progresit të fëmijëve;
  - Trajnim në punë për edukatorët;
  - Trajnim për Liderat e komunitetit;
- Sesione trajnuese mbi të drejtat e fëmijëve, zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe prindërimin;
- Festimi i Ditës Ndërkombëtare të Romëve dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve Rom;
  - Konferencë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve;
- Ofrimi i shërbimit shëndetësor për fëmijët e targetuar dhe informim i prindërve të tyre;
- Regjistrimi civil i fëmijëve dhe ngritja e kapacitetit të prindërve Rom për të zgjidhur problemet e regjistrimit civil.

# Arritjet e projektit

**164**

fëmijë të moshës 3-6 vjeç, frekuentues të kopshteve, janë mbështetur me mjete didaktike të nevojshme për vitin shkollor 2015-2016

**254**

fëmijë janë mbështetur për vitin shkollor 2016-2017

**54**

fëmijë të moshës 6 vjecare janë asistuar për të kaluar nga kopshti drejt frekuentimit të shkollës në klasë të parë

**30**

lider komuniteti dhe aktivistë Romë janë trajnuar për menaxhimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe fuqizimin e bashkëpunimit me pushtetin lokal

**11**

klasa të kopshteve janë kompletuar me pajisje, mjete didaktike dhe lodra për fëmijët

**8**

edukatore janë trajnuar nga specialist të Institutit të Zhvillimit Arsimor (IZHA) për përmirësimin e mësimdhënies dhe të punuarit me fëmijë të grupeve vulnerabël



## Mbi 230

raste lindjesh janë asistuar nga projekti për t'u regjistruar në zyrat e gjendjes civile, shoqëruar edhe me shërbime shtesë të nevojshme si nxjerrje karte identiteti, lidhje martesë për prindërit e fëmijëve, transferta vendbanimi etj

- Janë organizuar trajnime të ndryshme mbi prindërimin dhe çështje të ndjeshme sociale janë zhvilluar vazhdimisht në të gjitha zonat e projektit
- Janë zhvilluar tryeza të rrumbullakta me pjesëmarrjen ofruesve publikë dhe privatë të shërbimeve në nivel lokal
- Fëmijët e kopshteve të projektit kanë patur kontroll mjekësor periodik nga ana e mjekëve pediatër si dhe këshilla mbi kujdesin ndaj shëndetit janë ofruar për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve
- Janë organizuar aktivitete lobuese dhe advokuese për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të fëmijëve
- Janë organizuar aktivitete me fokus promovimin e të drejtave dhe identitetit të komunitetit Rom në kuadër të 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve si edhe Janë shpërndarë dhurata për fëmijët me rastin e festive të fund-vitit, etj

# ARSIMI GJITHPËRFSHIRËS

**A**rsimimi konsiderohet si prioritet kombëtar për të luftuar varfërinë, për të mbrojtur fëmijët nga rreziqet sociale si trafikimi dhe përdorimi i drogave, për të promovuar të drejtat e njeriut dhe demokracinë, për të çuar përpara zhvillimin kombëtar dhe njerëzor, për të mbrojtur mjedisin dhe për të inkurajuar kohezionin social. Megjithatë, ashtu si shumë vende në zhvillim, Shqipëria vazhdon të përballet me sfida lidhur me zgjerimin e arsimit parashkollor cilësor për fëmijët në komunitetet më të marginalizuara.

- Arsimi është një e drejtë njerëzore për çdo fëmijë për të mbrojtur të drejtën për arsim të fëmijëve pjesë e komuniteteve më të marginalizuara.
- Arsimi cilësor është hapi i parë drejt zhvillimit kombëtar të barabartë, pakësimit të varfërisë dhe kohezionit social.
- Barazia në aksesin ndaj arsimit është në thelb të përpjekjeve për të arritur akses universal në arsim.
- Përpjekjet për përmirësimin e arsimit janë më efektive kur angazhojnë të gjitha grupet e interesit, përfshirë prindërit, nxënësit dhe drejtuesit e komuniteteve nga komunitetet e marginalizuara.

Qëllimi gjithëpërfshirës është të pakësojë numrin e largimeve të hershme nga shkolla për të siguruar që të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjendja ekonomike, të jenë pjesë e arsimit parashkollor dhe të përfundojnë arsim bazë cilësor dhe të barabartë.

Në arsimin parashkollor, të gjitha mjediset e fëmijëve duhet të jenë 'miqësore' pra, duhet të jenë të shëndetshëm, efektive për qëllimin e tyre, mbrojtës për ta si dhe të përshtatshëm me një staf të mirëkualifikuar. Kjo siguron arritje më të mëdha të fëmijëve, forcon shëndetin dhe mirëqënien e tyre, inkurajon përfshirjen e fëmijëve në arsim parashkollor, rritin moralin e mësuesve (pra janë miqësore edhe për ta), garanton hapësira të mbrojtura për fëmijët, mobilizon mbështetjen e komunitetit për arsimin, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e fëmijëve në shkollë dhe shoqëri.

Konventa e të Drejtave të Fëmijës jo vetëm që insiston që fëmijët të gëzojnë të drejtën për arsimim, por gjithashtu thekson se përmbajtja, proceset dhe mjediset që sigurohen për edukimin duhet t'i shërbejnë të mësuarit real, pra atij me cilësi dhe që ka kuptim për jetën e fëmijës. Këto mjedise kërkojnë mësues të përkushtuar, të angazhuar, të gatshëm për të investuar në zhvillimin e tyre profesional që lidhen me çështjen e gjithëpërfshirjes.

Mjediset “miqësore” për fëmijët janë ato mjedise që bazohen dhe udhëhiqen nga të drejtat e tyre:

- **gjithëpërfshirëse** – se respektojnë diversitetin dhe sigurojnë shanse të barabarta për çdo fëmijë;
- **të shëndetëshme** - se sigurojnë shëndetin fizik si dhe psiko-socio-emocional të fëmijëve duke nxitur sjellje, qëndrime dhe praktika të shëndetëshme që çojnë në vlerësimin dhe besimin te vetja;
- **efektive** - mbasi sigurojnë një edukim cilësor të bazuar në realitetin e jetës së fëmijës duke u dhënë mjeshtëri për jetën duke rritur kapacitetet e mësuesve, moralin e tyre, statusin si dhe të ardhurat;
- **mbrojtëse** - se i sigurojnë fëmijët nga abuzimet brenda dhe jashtë saj;
- **të ndjeshme ndaj problemeve gjinore** – se eliminon stereotipet gjinore;
- **bashkëpunuese me familjet dhe komunitetin** – në të mirë të fëmijëve.

## Të drejtat e fëmijëve

Motoja një “Arsim për të gjithë fëmijët” ndihmon mësueset dhe drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor që të krijojnë një klimë miqësore dhe një mjedis gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët. Në këtë lloj klime dhe mjedisi çdo fëmijë ndihet i mirëpritur dhe i barabartë më të tjerët, si dhe merr pjesë e përfshihet me dëshirë e në mënyrë aktive në veprimtaritë që zhvillohen në grup.

Gjithashtu, synon që mësueset, duke u mbështetur në tregime ose përralla të ndryshme, të planifikojnë tema dhe veprimtari të cilat ndërthurrin dhe integrojnë gjashtë fushat e programit të arsimit parashkollor si: zhvillimi gjuhësor, zhvillimi matematikor, zhvillimi shkencor, zhvillimi fizik, edukimi social dhe artistik.

Subjektet e përrallave të përzgjedhura ofronjnë mundësi që nxënësit në mënyrë të natyrshme të marrin mesazhe që kanë të bëjnë me pranimin, respektin dhe dashurinë ndaj njëri- tjetrit, pavarësisht cilësive e veçanta që ka gjithësecili fëmijë në kopsht.

### Dr. Dorina Rapti

Përgjegjëse e sektorit të trajnimit  
dhe kualifikimit të mësuesve

Instituti i Zhvillimit të Arsimit



# KONFERENCË KOMBËTARE NË KUADËR TË 20 NËNTORIT, DITËS NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Unioni Amaro- Drom, në kuadër të 20 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, organizoi Konferencën Kombëtare “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve Rom në Shqipëri”.

Ky aktivitet mblodhi së bashku aktorë të ndryshëm të cilët kanë në fokus punën me fëmijët dhe mbrojtjen e të drejtave. Në aktivitet ishin pjesëmarrës përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Rrjetit BKTF, Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, drejtorë shkollash nga rrethe të ndryshme të vendit, stafe edukative të kopshteve, lider komuniteti, aktivistë romë etj.

Hapja e aktivitetit u bë nga z. Skënder Veliu, Drejtor Ekzekutiv i Unionit “Amaro-Drom”, i cili i njohu pjesëmarrësit me qëllimin e aktivitetit dhe simbolikën e kësaj date të shënuar.

Pavarësisht se minoriteti rom është një ndër minoritetet më të mëdha në Shqipëri, ai përballlet me kushte shumë të vështira social-ekonomike të cilat reflektohen në strehim, shëndetësi, punësim, arsim etj. Bazuar në raporte të ndryshme për komunitetin Rom, pjesa më e madhe e familjeve Rome në Shqipëri, jetojnë në kushte ekstreme të varfërisë. Varfëria tek Romët në Shqipëri është afërsisht në nivelin 70% krahasuar me 20% që është niveli i varfërisë në popullsinë maxhoritare, - u shpreh z. Veliu.

Aksesi i limituar në edukim dhe shëndetësi ndikon seriozisht përfshirjen sociale dhe integrimin e këtyre fëmijëve në shoqërinë mazhoritare. Për më tepër, ndërmjet prindërve, nuk ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm për rëndësinë e edukimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve. Pjesën më të madhe të rasteve, prindërit, në papunësi të lartë dhe me nivel të ulët aftësish për të qenë konkurrues në tregun e punës, përfshijnë shpeshherë fëmijët e tyre në aktivitete për të rritur të ardhurat e familjes.

Z. Veliu theksoi se prej afro dy dekadash, Unioni “Amaro-Drom”, ka zbatuar dhe zbaton një sërë projektesh, në fusha të ndryshme, me qëllim nxitjen e përfshirjes sociale të komunitetit Rom në Shqipëri dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij komuniteti. Mirëqenia dhe shëndeti i fëmijëve, është një çështje që na prek të

gjithëve dhe të gjithë duhet të jemi pjesë e zgjidhjeve për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët.

Çdo fëmijë duhet të ndihet i vlerësuar dhe të ketë mundësi të zhvillojë potencialin e tij. Të përiqemi të gjithë së bashku t'u ofrojmë fëmijëve tanë një mjedis të sigurtë, të ngrohtë dhe gjithpërfshirës – ishte mesazhi me të cilin përmbylli fjalimin e tij Z. Veliu.



Përfaqësuesja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim, znj. Amarda Çoku, u shpreh se mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është një çështje shumë e rëndësishme për institucionin të cilin ajo përfaqëson. Zyra e Komisionerit Kundër Diskriminimit gjithmonë ka qënë e hapur për pritjen dhe trajtimin e të gjitha ankesave që adresohen qoftë nga individët apo institucionet e ndryshme. Kjo zyrë ka një procedurë të përcaktuar e cila fillon që me paraqitjen e një formulari të posaçëm të plotësuar nga ana e ankuesit. Zyra e Komisionerit i ka dhënë zgjidhje një sërë rasteve dhe ankesave duke i trajtuar gjithmonë objektivisht dhe bazuar në fakte. Ata kanë ndërhyrë për disa raste të paraqitura përmes ankesave për segregim të fëmijëve të komunitetit Rom në shkolla. Kjo zyrë ka dhënë rekomandime edhe për mënyrën e shkrimit të teksteve të shkollave në mënyrë që të mos përmbajnë tekste diskriminuese apo paragjyquese. Znj. Çoku u shpreh se diskriminimi ndaj romëve është një fenomen që ekziston dhe ndeshet në shumë aspekte të jetës. Ky fenomen vihet re edhe te sjellja e prindërve të maxhorancës apo fëmijëve të tyre në shkolla, etj. Ajo u kërkoi stafeve edukative

të jenë vigjilentë dhe të ndjeshëm ndaj këtyre rasteve dhe të mos lihen në hije. Në përfundim të fjalës së saj, znj. Çoku shprehu kërkesën që shkollat të bashkëpunojnë me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për organizimin e orëve të hapura me nxënësit e shkollave. I gjithë stafi i këtij institucioni është shumë i hapur për të bashkëpunuar, për të ofruar trajnime apo sesione informuese.

Znj. Rajmonda Bozo, drejtore e Shërbimit Ligjor Falas (TLAS) dhe njëherësh drejtuese për një kohë të gjatë e rrjetit "Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve" BKTF ishte gjithashtu pjesë e panelit të këtij aktiviteti.

Znj. Bozo gjatë fjalës së saj foli në lidhje me misionin e rrjetit BKTF dhe Shërbimit Ligjor Falas dhe kontributit që është dhënë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi. Rrjeti BKTF si koalicion është i fokusuar në ndërhyrjet parandaluese dhe së fundmi është përfshirë në procesin e përmirësimit të legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ka shumë struktura shtetërore apo private të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët por është shumë e nevojshme që këto struktura të njihen nga qytetarët dhe akoma më e rëndësishme është edhe koordinimi midis të gjitha strukturave. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) kanë një rol të rëndësishëm duke ofruar një shërbim multidisiplinar. Zyra e TLAS ka një bashkëpunim shumë të ngushtë me këto Njësi. Znj. Bozo tregoi disa shembuj konkretë të bashkëpunimit që zyra e TLAS ka patur me Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve por edhe me zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për t'i dhënë zgjidhje shumë rasteve regjistrimit të lindjeve në zyrat e gjëndjes civile apo trajtimit të rasteve të diskriminimit të fëmijëve.

Gjatë fjalës së saj, znj. Bozo u ndal edhe një fenomen i cili sipas saj po bëhet shumë shqetësues vitet e fundit me zhvillimet teknologjike, i cili ka të bëjë me dhunën kibernetike. Sot teknologjika ka evoluar dhe fëmijët sot janë në rrezik nga ekspozimi apo presioni në rrjetet sociale. Znj. Bozo u bëri kërkesë mësuesve por edhe prindërve që të tregohen vigjilentë dhe të jenë pranë fëmijëve të tyre si dhe të drejtohen pranë specialistëve për të marrë më tepër informacion apo asistencë të nevojshme. Bashkëpunimi shkollë komunitet është shumë i rëndësishëm.

Fëmijët pa shtetësi janë një tjetër kontigjent fëmijësh të cilët janë të risk dhe të privuar nga një sërë të drejtash. Vazhdojmë të kemi raste të shumta të fëmijëve të pa regjistruar apo pashtetësi. Por, nuk ka raste të pazgjidhshme. Ato mund të zgjidhen ose me rruge administrative apo ligjore, mjafton që të identifikohen dhe referohen aty ku duhet. Amaro-Drom dhe Shërbimi Ligjor Falas Tirane kanë bërë shumë në këtë drejtim.

Z. Besnik Rama, përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) u shpreh se vëmendja e kësaj Ministrie ndaj fëmijëve Rom është maksimale. Sipas tij, kemi tregues pozitiv të pjesëmarrjes së fëmijëve Rom në shkollë. Për vitin shkollor 2015-2016 janë 1600 fëmijë Rom më shumë në shkollë se një vit më parë. Prej vitesh fëmijët Rom kanë kuota të veçanta në arsim. Kontigjenti i fëmijëve Rom që përfundojnë arsimin e lartë janë një shembull shumë pozitiv. Prej vitesh i kemi dhënë përparësi përfshirjes dhe pjesëmarrjes së prindërve Rom në Bordet Drejtuese brenda mjediseve shkollore. Veprimtaritë jashtë shkollore si kampet verore apo aktivitetet në kuadër të 8 prillit dhe festave të tjera janë aktivitete të cilat shërbejnë për të socializuar fëmijët me njëri-tjetrin dhe për të luftuar fenomene si paragjykimi apo diskriminimi. Ministria e Arsimit dhe Sportit i ka parë me vëmendje të gjitha ankesat e ardhura nga Avokati i Popullit,



Komisioneri Kundër Diskriminimit apo organizata të ndryshme. Lind nevoja të rrisim bashkëpunimin shkollë-komunitet me qëllim që komuniteti rom të ketë një qasje më të madhe në sistemin arsimor. Faktor suksesi është klima paqësore në shkollë. Kjo klimë paqësore do të influencojë në çdo mjedis social. Për integrimin e komunitetit Rom ka ardhur koha të hidhet një hap për përfshirjen në kurrikul të gjuhës Rome. Le të marrim si model kurrikulën Rome të përdorur në Kosovë dhe ta përshtasim në kurrikulën tonë. Të krijohet mundësia që gjuha Rome të mësohet si gjuhë e dytë me zgjedhje në shkolla. Në këtë mënyrë fëmijët Rom vazhdojnë të ruajnë gjuhën dhe identitetin e tyre.

Z. Erion Xhaibra , përfaqësues i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve gjatë fjalës së tij falenderoi organizatën “Amaro-Drom” për kontributin e dhënë ndër vite për Minoritetin Rom dhe veçanërisht për fëmijët. Problemi më i madh është arsimimi pasi me të lidhen të gjitha fenomenet e tjera. Ai u shpreh optimist për shkak se gjërat po fillojnë të ndryshojnë për mirë. Aktualisht është një moment shumë i rëndësishëm për Romët pasi po draftohet ligji për Pakicat Kombëtare.

Një nga rekomandimet që bëri Z. Xhaibra ishte vendosja e mësuesve suplementarë në kopshte dhe shkolla ku ka fëmijë Rom.

Gjatë aktivitetit, shumë drejtues shkollash dhe mësues dhe aktivistë Rom të cilët ishin të pranishëm në aktivitet ndanë informacion, rekomandime dhe mesazhe të shumta në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Disa nga çështjet që u diskutuan ishin:

- Braktisja e shkollës nga fëmijët sidomos nga vajzat e komunitetit rom;
- Ri-integrimi i fëmijëve që kthehen nga emigracioni;
- Fëmijët e paregjistruar në gjendjen civile dhe mungesa e dokumentacionit përkatës të nevojshëm për regjistrim në shkollë;
- Shfrytëzimi i fëmijëve dhe krijimi i vendbanimeve të veçuara – ky është një problem shqetësues veçanërisht në Shkodër , etj.



DITA NDËKOMBËTARE  
E ROMËVE,  
8 PRILL 2016



8 Prilli është Dita Ndërkombëtare e Romëve. Në po këtë datë, në vitin 1971 është organizuar për herë të parë në Londër, Konferenca Ndërkombëtare e Romëve. Në këtë takim u vendos hymni Rom "Gelem Gelem" dhe flamuri Rom. Që prej këtij momenti, 8 Prilli festohet në të gjithë botën si "Dita Ndërkombëtare e Romëve".



Në kuëdër të kësaj dite, Unioni “Amaro-Drom” organizoi disa aktivitete në zona të ndryshme të Shqipërisë. Këto aktivitete kishin si qëllim transmetimin e mesazheve në lidhje me të Drejtat e Romëve, të Drejtat e fëmijëve dhe mesazhe për bashkëjetesën dhe integrimin.

“Amaro-Drom” bashkëpunoi me organizata të ndryshme dhe institucione lokale për organizimin e aktiviteteve.

Në Fier, “Amaro-Drom” bashkëpunoi me Bashkinë e Fierit, DAR Fier, Qëndrën Sociale Murialdo, Roma Active Albania, Voice of Roma etj për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.



Në datat 7-8 Prill, në ambjentet e “Qendres Sociale Murialdo” rreth 300 fëmijë nga shkolla të ndryshme të rajonit të Fierit u përfshinë në aktivitete argëtuese dhe sportive. Nxënësit e çdo shkolle pjesëmarrëse kishin përgatitur një program të shkurtër me këngë, valle dhe mesazhe të ndryshme kundër diskriminimit. Koordinatori Lokal i Amaro-Drom, mbajti një fjalim në të cilin foli për simbolikën e ditës së 8 Prillit dhe gjithashtu adresoi mesazhe të rëndësishme për përfaqësuesit e institucioneve lokale, të cilët ishin të pranishme në aktivitet.



Në Korçë, u organizua një aktivitet festiv në ambjentet e kopshtit "Lulet e vogla". Gjithashtu fëmijët e kopshtit, realizuan edhe një vizitë në institucionet e Bashkisë dhe Prefekturës Korçë, gjatë të cilës dhuruan një shportë me lule dhe një kartolinë e cila përmbante një mesazh drejtuar institucioneve për më tepër vëmendje dhe mbështetje ndaj fëmijëve Rom.



Në Shkodër, aktiviteti u zhvillua në ambjentet e shkollës "Liria". Ky aktivitet përmbante organizimin e një tryeze të rrumbullakët me përfaqësues të Institucioneve Lokale dhe antarë të komunitetit. Në vijim u zhvillua një aktivitet festiv me nxënësit e kopshtit dhe të shkollës. Drejtorja e shkollës u kujdes për organizimin e një aktiviteti sa argëtues aq edhe edukues dhe ndërgjegjësues.

Në Moravë - Berat u zhvillua një aktivitet festiv me pjesëmarrjen e fëmijëve të kopshtit dhe shkollës "Shaban Sollaku". Nxënësit e kopshtit dhe të shkollës performuan vjersha, këngë dhe kërcime të ndryshme të cilat u ndoqën me kënaqësi nga të ftuarit, përfaqësues të institucioneve lokale, organizatave lokale, stafi edukativ i shkollës, prindër dhe antarë të komunitetit.



# Shkëmbim eksperience midis stafëve edukative në kopshtin e lagjes “STAN”

## Morave - Berat



**14 -15 Prill 2016,**  
Lagjia “Stan”  
Morave - Berat

Në datat 14 -15 Prill 2016, në kopshtin ne lagjen “Stan” Morave - Berat u zhvillua aktiviteti shkëmbim eksperience midis stafëve edukative të kopshteve “Lulet e vogla” Korçë, “Hamil” Fier dhe kopshti i lagjes “Liria” Shkoder.



Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të kontribuonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimin e eksperiencës midis stafëve edukative të kopshteve të targetuara nga projekti. Në këtë aktivitet morrën pjesë edukatorët, drejtorët e kopshteve dhe koordinatorët lokalë të zonave të projektit.



Z Skënder Veliu, Drejtori Ekzekutiv i Unionit Amaro-Drom bëri një prezantim të punës që Unioni Amaro-Drom ka bërë ndër vite në mbështetje të komunitetit Rom të Moravës. Që prej vitit 2002 Amaro-Drom ka zbatuar një sërë projektesh në këtë komunitet. Projektet kanë qënë të fushave të ndryshme dhe të mbështetura nga donatorë të ndryshëm. Disa prej projekteve kanë patur si qëllim reduktimin e analfabetizmit dhe rritjen e nivelit të edukimit të fëmijëve të komunitetit Rom. Për këtë qëllim në bashkëpunim me Komunën Otllak është ndërtuar një godinë e cila përmblyhet me ambiente të ndryshme si një qender komunitare, kopësht, qender shëndetësore, dhe klasa shkolle për arsimin fillor. Kjo godinë është rikonstruktuar vitin e kaluar sërish dhe vazhdon të jetë funksionale.

E gjithë baza materiale në kopësht është ofruar në kuadër të projektit "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social të komuniteteve Rome në Shqipëri".

Drejtoresha e kopshtit dhe e shkollës, Znj. Valbona Çollaku foli në lidhje me edukimin e fëmijëve Rom në zonën e Moravës. Ajo deklaroi se komuniteti Rom në zonën e Beratit përballet me vështirësi të shumta social ekonomike. Ka një numër të konsiderueshëm të familjeve të divorcuara dhe pasojat vihen re te fëmijët përse i përket ndjekjes së shkollës apo frekuentimit të regullt nga ana e fëmijëve. Sipas drejtoreshës, kopshti në lagjen "Stan" ka dhënë një kontribut të çmuar në lidhje me përgatitjen e fëmijëve rom për në shkollë. Fëmijët Rom në përgjithësi kanë patur probleme në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe për shkak se në familjet e tyre përdonin romane. Kopshti është vendi i duhur ku fëmijët socializohen dhe përgatiten për në shkollë. Një rol të veçantë ka patur edhe koordinatoresha lokale pasi ajo është një aktiviste e hershme e këtij komuniteti. Ajo përveç punës së vazhdueshme ndërgjegjësuese që bën me prindërit e fëmijëve, ka qënë një ndihmesë shumë e madhe edhe për edukatoren pasi ka ndihmuar në komunikimin e edukatores me fëmijët.

Në vijim të gjithë pjesëmarrësit ndoqën një orë mësimi, dhe më pas edukatorët biseduan në lidhje me përshtypjet e tyre nga kjo vizitë.

Aktiviteti vazhdoi me një vizitë në shkollën 9-vjecare "Shaban Sollaku". Kjo shkollë frekuentohet nga fëmijët Rom të cilët përfundojnë klasën e 5-te pranë shkollës "Avdyl Avdia". Sipas drejtoreshës, vazhdon të jetë problem braktisja e shkolles nga fëmijët Rom. Një pjesë shumë e vogël e tyre arrijnë të përfundojnë klasën e 9 dhe më pas të vazhdojnë shkollën e mesme. Është diskutuar disa here ideja për të zhvendosur fëmijët Rom që zhvillojnë mesim kolektiv në shkollën "Avdyl Avdia" por shkolla është larg vendbanimeve të familjeve Rome. Familjet nuk kanë mundësi të paguajnë për transport.

Sipas Drejtoreshës, çështja e fëmijëve Rom që studiojnë në shkollën në komunitet është trajtuar edhe nga organizata ERRC, Avokati i Popullit dhe Komisioneri anti-diskriminim për faktin se është përcaktuar si shkollë e segreguar, por Drejtoria Arsimore e ka fituar çështjen pasi ky institucion e ka për detyrë dhe përgjegjësi të ofrojë mësues të kualifikuar gjë e cila është përmbushur më së miri.

Në përfundim të aktivitetit, pjesëmarrësit diskutuan në lidhje me modelet e ndryshme që janë gjatë vizitave në zonat e projektit në Korçë, Shkodër dhe Berat. Pjesëmarrësit e vlerësuan mundësinë që u dha projekti për të vizituar kopshte të tjera dhe të krijojnë kontakte të reja. Edukatorët deklaruan se kanë filluar të aplikojnë modelet e mësimdhënies të cilat i kanë pëlqyer në kopshtet të cilat kanë vizituar.

# REGJISTRIMIT CIVIL, ENDE NJË ÇËSHTJE E PAZGJIDHUR PËR ANTARËT E KOMUNITETIT ROM

Regjistrimi në zyrat e gjendjes civile është regjistrim i përhershëm i detyrueshëm (siç është lindja, vdekja, martesja, ndarje, ndryshimi i emrit dhe ngjarje tjera të lidhura për qytetarë (si birësimi, shtetësia, migrimi) në përputhje me kërkesat ligjore të Shqipërisë.

Roli i qytetarit në mirëmbajtjen e sistemit të gjendjes civile është vendimtar. Pa regjistrim nga ana e qytetarit në zyrat e gjendjes civile, (lindje, martesja, vdekja) cilësia e të dhënave të gjendjes civile nuk është e saktë, e plotë apo e azhurnuar. Ato do të kenë pasoja për cilësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë të dokumenteve të gjendjes civile që kanë të bëjnë me certifikatat dhe dokumentat identifikuese. Çdo qytetar ka të drejta (për të marrë shërbimin) gjithashtu qytetarët kanë obligime ligjore (të regjistrojnë ngjarjet e gjendjes civile në mënyrë të saktë dhe në kohë).

Siç dihet, problemet e regjistrimit në radhët e komunitetit rom janë të shumta. Në nivel kombëtar, fëmijë të pa regjistruar mendohet të jenë shumë. Fenomeni nuk është vetëm tek komuniteti rom por edhe tek ai jo rom.

Nga census i vitit 2011 rezultoi se 7,743 persona ishin të pa regjistruar ku 80% ishin nga komuniteti rom dhe egjiptian.

Ky fenomen mund të trashëgohet nga njëri brez në tjetrin, duke qenë se prindërit e paregjistruar do ta kenë të pamundur të regjistrojnë lindjen e fëmijëve të tyre. Në këtë mënyrë, ka gjasa që numri i personave të paregjistruar të rritet, nëse nuk gjendet një procedurë e qëndrueshme për të gjithë sistemin.

## Disa prej faktorëve pengues për regjistrimin e femijeve rom në zyrat e gjendjes civile janë:

- Mos pajisja me dokumentin e aktit të lindjes së fëmijës në rastet e lindjeve në institucionet shëndetësore dhe ato jashtë institucioneve, jashtë vendit;
- Rastet e ndryshimit të vendbanimit, për shkak të mungesës së certifikatës së pronësisë ose të kontratës së qirasë së banesës në bashkinë ku janë shpërngulur. Shumica e romëve nuk i kanë këto dokumente, pasi shumë prej tyre jetojnë në kasolle/barraka të improvizuara ose në banesa të palegalizuara ;
- Regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë shtetit mbetet një sfidë e vështirë pasi prindërit/të interesuarit janë deportuar nga vendet e hapësirës " SHENGEN" e për pasojë nuk mund të sigurojnë vet dokumentet. Kjo gjendje kërkon ndihmë juridike qoftë edhe nëpërmjet shërbimeve konsullore shqiptare që operojnë në këto shtete, që shpesh romët nuk mund t'i përballojnë financiarisht;
- Niveli i ulët ekonomik pengon familjet rome për të përballuar shpenzimet financiare në zyrat e gjendjes civile.

Prej vitesh Unioni "Amaro-Drom" është angazhuar për të ndihmuar antarët e komunitetit Rom të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile dhe në këtë mënyrë të kenë mundësinë të jenë përfitues të shërbimeve publike.

Përfaqësuesit e degëve të Unionit "Amaro-Drom" kanë bërë një punë të admirueshme në identifikimin e rasteve të fëmijëve të paregjistruar në zyrat e gjendjes civile në komunitetet ku jetojnë. Një numër i konsiderueshëm rastesh janë asistuar dhe zgjidhur, kjo falë edhe mbështetjes së shumë donatorëve të cilët kanë financuar projektet e zbatuara nga "Amaro-Drom" si: UNDP, Delegacioni i BE në Shqipëri, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), We Effect dhe Radiohjalpen.



**Ferit Milanj**

Lehtësues në procesin e regjistrimit civil

Një kontribut të çmuar ka dhënë edhe Klinika Ligjore Falas në Tiranë (TLAS) me të cilën Amaro-Drom ka një bashkëpunim të gjatë dhe të suksesshëm. Një numër i lartë rastesh të identifikuar dhe referuara nga "Amaro-Drom" janë ndjekur në gjykatë dhe janë zgjidhur nga kjo Klinikë.

Prej muajit qershor 2015, Unioni Amaro-Drom është duke zbatuar projektin "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet rome në Shqipëri" financuar nga We Effect dhe Radiohjalën.

Projekti zbatohet në 4 zona (Moravë - Berat, Baltëz -Fier, Korçë dhe Shkodër)

Një komponent shumë i rëndësishëm i këtij projekti është regjistrimi civil.

Der më tani, janë asistuar dhe zgjidhur mbi 230 raste. Ndihma e ofruar ka konsistuar në ofrimin e informacionit mbi dokumentacionin e kërkuar, shoqërimi i prindërve në zyrat e gjëndjes civile, pagesat e shpenzimeve të ndryshme të lidhura me regjistrimin civil si dhe shërbime të tjera si Lidhje martesë, karta identiteti, etj.

Në secilën prej zonave të projektit janë zhvilluar seanca informimi mbi rëndësinë e regjistrimit civil dhe adresimi rrezikut të pashtetësisë në komunitetet Rome në Shqipëri.

## Antarët e komunitetit Rom u informuan mbi disa çështje të rëndësishme si:

- **Cfare do të thotë të jesh pa shtetësi ?**
- **Cilat janë shkaqet e mbetjes pa shtetësi ?**
- **Cilat jane pasojat qe hasin njerezit pa shtetësi ?**
- **Cilat jane dokumentat baze të lindjes ?**
- **Ku deklarohen lindjet ?**
- **Ku regjistrohen lindjet ?**

Çështja e regjistrimit civil do vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e punës së Unionit "Amaro-Drom" me qëllim që asnjë fëmijë i këtij komuniteti të jetë i privuar nga e drejta e tij për të patur një identitet.

# Tryeza të rrumbullakta me ofruesit e shërbimeve në nivel lokal



Koordinimi, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet ofruesve të shërbimeve ka një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë te qytetarët, të cilët janë përfitues të këtyre shërbimeve.

Me qëllim nxitjen e dialogut midis ofruesve të shërbimeve për ofrimin e një mbështetje sa më efektive për antarët e komunitetit Rom, veçanërisht fëmijët, Unioni Amaro-Drom ka vijuar të organizojë tryeza të rrumbullakta në 4 zona (Fier, Berat, Shkodër, Korçë) në të cilat është duke u zbatuar projekti "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social të komuniteteve Rome në Shqipëri" financuar nga We Effect dhe RdiOhjalpen.

Në këto tryeza marrën pjesë përfaqësues të Bashkive përkatëse, Drejtorive Arsimore Rajonale, Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve, Drejtorive Rajonale të Shëndetit, Zyrave të Gjëndjes Civile, Zyravë të Punës, Qendrave të

Formimit Profesional, Dejtore kopshtesh dhe shkollash, përfaqësues të organizatave, lider dhe antarë të komunitetit Rom etj.

Drejtori Ekzekutiv i Unionit Amaro-Drom, falenderoi për bashkëpunimin të gjithë aktorët e përfshirë në projekt gjatë vitit 2016, veçanërisht stafet edukative të cilat kanë qënë të përkushtuara për përfshirjen e fëmijëve Rom në sistemin arsimor. Ai nënvizoi rëndësinë që ka bashkëpunimi dhe përfshirja e institucioneve publike në të tilla bashkëpunime me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve që bëhen nga organizata apo donatorë të ndryshëm.

Pjesëmarrësit në këto tryeza u njohën me aktivitetet e zbatuara nga Unioni Amaro-Drom në kuadër të projektit dhe impaktit që ato kanë patur te fëmijët dhe në komunitet në përgjithësi.

## Çështjet kryesore të cilat u diskutuan në këto tryeza ishin:

- Roli i rëndësishëm i liderave të komunitetit dhe aktivistëve Rom si një urë lidhëse midis antarëve të komunitetit Rom dhe zyrave të ofrimit të shërbimit,
- Nevoja për vazhdim të ndërgjegjësimit të prindërve të fëmijëve mbi rëndësinë që ka edukimi;
- Nevoja për më tepër ndërhyrje nga ana e pushtetit lokal në zonat ku banon pupullsia e komunitetit Roma apo grupe të tjera vulnerabël;
- Institucionet arsimore vazhdojnë të kenë nevoja të shumta përsa i përket infrastrukturës së ndërtesave me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e mësimin. Vazhdon të jetë një problem shqetësues mungesa e tualeteve në shkollën "Trifon Prifti" Hamil – Fier. Kjo gjë ka një ndikim negativ në frekuentimin e shkollës dhe kopshtit nga fëmijët. Gjithashtu kopshti në Lagjen "Stan" Moravë-Berat ka një hapësirë shumë të vogël krahasuar me numrin e fëmijëve që e frekuentojnë rregullisht atë kopësht. Megjithatë, ky kopësht u vlerësua nga pjesëmarrësit në tryezë si një shëmbull pozitiv për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve që e frekuentojnë rregullisht atë. Kjo edhe falë mbështetjes që ka dhënë Unioni Amaro-Drom por edhe punës së koordinatores lokale në këtë zonë. U përmend gjithashtu se në qytetin e Beratit ka kopshte të tjera të cilat kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje.
- Çështja e regjistrimit civil vazhdon të mbetet një çështje e prekshme për komunitetin Rom. Projekti i zbatuar nga Amaro-Drom ka asistuar një numër të konsiderueshëm rastesh të regjistrimit të lindjeve të fëmijëve Rom në zyrat e gjëndjes civile.



- Antarëve të komunitetit Rom u mungon informacioni mbi shërbimet publike dhe si mund të përfitojnë prej tyre. Institucionet qeveritare duhet të jenë më transparente dhe të organizojnë takime informuese në komunitet.
- Niveli i punësimit në përgjithësi në të gjitha zonat e projektit është shumë i ulët, familjet jetojnë në kushte shumë të këqia dhe varfëria vazhdon të mbetet një problem.
- UNDP do të zbatojë në zonën e Beratit dhe Shkodrës një projekt që targeton komunitetin Rom dhe Egjiptian. Në takim u diskutua mbi mundësitë për krijimin e sinergjive midis aktorëve të ndryshëm.
- Edukatorët u shprehën të kënaqura me frekuencimin e rregullt të kopshtit nga fëmijët që prej momentit të fillimit të projektit. Ndihma e ofruar në kuadër të projektit ka patur një impakt pozitiv në këtë drejtim.
- Ndihma me bazë materiale për kopshtet dhe aktivitetet e tjera u vlerësuan nga stafi edukativ dhe përfaqësuesit e Drejtorive Arsimore Rajonale.





# E SHOH NË SYTË E TYRE ...

**Ata vijnë çdo mëngjes të qeshur, të dashur me të gjitha energjitë që jeta iu fal.**

Ky është çasti kur për mua fillon përgjegjësia, një përgjegjësi që ka rrënjët në besimin që duhet të justifikoj në përditshmërinë e punës time. Këta prindër, të lodhur nga hallet e jetës, besojnë se bijtë e tyre, do të kenë një të ardhme më të mirë se ata. Kjo e ardhme, hedh hapat e parë në kopshtin tim. Në sytë e tyre, shoh dëshirën për të njohur botën që i rrethon. Ajo është e madhe dhe të përkushtohesh për ta, është pak. Përqafimet që më dhurojnë, janë sinjal shumë i mirë për raportet tona, të cilat i ndërtojmë të tilla ku bashkëpunimi është i shkëlqyer.

Çdo ditë që kalon, shoh se si mënyra e shpenguar dhe pavarësia e të sjellurit, pak e nga pak fillojnë të disiplinohen brenda kuadratave që institucioni kërkon. Ato fillojnë të unifikohen dhe rastet e veçanta janë fare sporadike. Duart e tyre të vogla që mezi mbajnë lapsin, fillojnë të lenë mbi fletë gjurmët e para. Në fillim të çorientuara, e pak e nga pak dallohen konturet e para që flasin për shpresë. Dhe ja një ditë, dallojmë çdo gjë të qartë. Fëmijët futen në rrugën e duhur, pas një përpjekje të madhe me vështirësitë ku shpesh lotët shoqërojnë gabimet e tyre. Shpesh punët i shoqëroj me shenja vlerësimi, të cilat janë një sadsfaksion i vërtetë tek secili. Qeshim, gëzojmë e ndajmë shpesh arritjen e tyre. Bukuria e këtij çasti nuk mbaron me kaq. Takimi me prindërit është një festë e vërtetë sa nuk mungojnë lotët e gëzimit në sytë e tyre. – Këtë e ka bërë djali im? – dëgjohen shpesh nga goja e tyre. Djali apo vajza e secilit, e ka të hapur derën e çdo shkolle si çdo banor tjetër në këtë vend. Hapat që po hedhin, janë të njëjta me këdo. Këndojnë, recitojnë tregojnë përralla dhe luajnë shumë.

Çdo ditë kur nis punën, sjell në mendje shprehjen e bukur kineze “Jepi fëmijës një peshk dhe ti po e ushqen për një ditë, mësoje të peshkojë dhe i ke siguruar ushqim për tërë jetën”.

Rruga drejt dijes, do ta mësojë atë të bëhet i zoti për jetën. Kështu besoj unë, prindërit dhe vetë ata, që me shumë çiltërsi, thonë se çdo të bëhen kur të rriten.

Kjo nuk është thjesht një ëndërr, por rruga e të nxënit, dalëngadalë do t’i shpjerë atje ku duan. Shpresoj shumë, e shoh në sytë e tyre...



**Natasha Qose**

Kopshti “Stan” Moravë- Berat

# SHKËMBIM EKSPERIENCE MIDIS STAFEVE EDUKATIVE NË SHKOLLËN “TRIFON PRIFTI” HAMIL FIER



Në datat 26-27 Maj 2016, në kopshtin “Trifon Prifti” Hamil u zhvillua aktiviteti shkëmbim eksperience midis stafeve edukative të kopshteve “Lulet e vogla” Korçë, Kopshtit të lagjes “Stan” Berat dhe kopshti i lagjes “Liria” Shkoder.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të kontribuonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimin e eksperiencës midis stafeve edukative të kopshteve të targetuara nga projekti. Në këtë aktivitet morrën pjesë edukatorët, drejtorët e kopshteve dhe koordinatorët lokalë të zonave të projektit.



Vizita ne kopshtin "Trifon Prifti" ishte vizita e fundit dhe përmbyllëse e aktiviteteve shkëmbim eksperience të cilat u realizuan në të gjitha kopshtet e përfshira në projekt.

Drejtori i shkollës dhe kopshtit Z. Helio Çela mirëpriti pjesëmarrësit dhe njëkohësisht bëri një prezantim të përgjithshëm të historikut të shkollës dhe komunitetit të Baltëzës. Ai theksoi se komuniteti i Baltëzes përbëhet nga familje të varfëra me probleme social ekonomike. Të ardhurat kryesore të familjeve vinin kryesisht nga emigracioni, por që prej krizës ekonomike në Greqi, gjendja është përkeqësuar. Ai gjithashtu nënvizoi se në Baltëz jeton një numër i konsiderueshëm i familjeve Rome. Ata janë të integruar me pjesën tjetër të popullsisë dhe nuk hasin diskriminim, por një nga problemet kryesore vazhdon të ngelet niveli i lartë i analfabetizmit, veçanërisht midis prindërve të rinj. Ai falenderoi "Amaro-Drom" për rritjen e numrit të fëmijëve që frekuentojnë kopshtin dhe shkollën. Koordinatori lokal gjithashtu ka patur një rol të rëndësishëm në projekt sipas Drejtorit të shkollës, ai është një urë lidhëse midis institucionit të shkollës dhe komunitetit Rom.

Më pas aktiviteti vazhdoi me një vizitë në kopsht. Pjesëmarrësit ndoqën programin mësimor të përgatitur nga edukatorja dhe fëmijët. Fëmijët ishin shumë aktivë gjatë orës së mësimit. Ata recituan vjersha, kënduan këngë dhe më pas u aktivizuan në një role play.

Pjesëmarrësit në aktivitet realizuan edhe një vizitë në të gjitha klasat e shkollës ku përshëndetën nxënësit dhe mësuesit.

Në përfundim të aktivitetit, të gjithë pjesëmarrësit diskutuan në lidhje me vështirësitë e përballura në punë e tyre gjatë gjithë vitit shkollor. Pothuajse të gjithë edukatorët e gjithë kopshteve të projektit theksuan se sigurimi i një vakti ushqimor në kopsht është dicka e nevojshme dhe një kërkesë e të gjithë prindërve. Ato deklaruan se shpesh herë detyrohen t'u blejnë vetë fëmijëve diçka për të ngrënë. Pjesëmarrja e fëmijëve ka qënë në përgjithësi e rregullt, një rol të rëndësishëm për këtë pjesë kanë patur edhe koordinatorët lokalë.

Trajnimi që u zhvillua për edukatorët nga projekti ishte shumë frytdhënës sipas edukatoreve. Ato përvetësuan metoda mësimdhënie shumë të vlefshme të cilat kanë filluar t'i praktikojnë gjatë punës së tyre.

Drejtori i unionit Amaro-Drom në përfundim të aktivitetit bëri një përmbledhje të situatës në të gjitha kopshtet e përfshira në projekt dhe të vizituara gjatë aktivitetit shkëmbim eksperience. Ai falenderoi gjithë stafin mësimor për organizimin e mirë gjatë vizitave të realizuara. Gjithashtu ai i falenderoi edhe për angazhimin e tyre gjatë gjithë jetës së projektit dhe bashkëpunimin që kanë patur me Unionin Amaro-Drom.



# Ndikimi që kanë **AKTIVITETET KREATIVE** dhe **LOJËRAT SOCIALE** në përshtatjen dhe në procesin e nxënies të fëmijët e grupmoshës **3-4** dhe **5-6 vjeç** në kopsht.

Loja ka ndikim pozitiv në zhvillimin intelektual të fëmijës. Përmes lojës fëmijët mësojnë shumë gjëra të reja dhe të dobishme por edhe jeta bëhet më e këndshme. Loja është një komponent thelbësor për zhvillimin dhe edukimin normal të çdo fëmije. Psikologë, pedagogë dhe studiues të shumtë në eksperimentet e bëra me fëmijë të moshave të ndryshme kanë vlerësuar se përmes lojës fëmijët aftësohen më shumë. Loja është një punë e fëmijës, është mjeti me anë të të cilit ai rritet e zhvillohet. Loja aktive e fëmijës shihet si një shenjë e shëndetit mendor ndërsa mungesa e lojës është një e metë e madhe. Studiues të shumtë që janë marrë me studimin lojës së fëmijës kanë konstatuar se: loja e fëmijës ka një vlerë të madhe për zhvillimin fizik, mendor dhe intelektual të tij. Përmes lojës fëmijët i realizojnë dëshirat e tyre. Përmes lojës fëmijët mësojnë shumë gjëra të reja dhe të dobishme prandaj edhe jeta bëhet më e këndshme për fëmijët tanë.

Aplikimi në kopshtin tonë I metodës "Mësoj duke Luajtur" ka rezultuar shumë efikas. Duke aplikuar një veprimtari të pëlqyeshme siç është loja, fëmijët kanë përvetësuar më me lehtësi koncepte të ndryshme, gjuhësore, shkencore dhe matematikore. Edhe në ditët e para të kopshtit kur për fëmijët është e vështirë

përshtatja, sidomos për fëmijët që frekuentojnë për herë të parë kopshtin, loja ka rezultuar një metodë e suksesshme. Me anë të lojës fëmijët janë njohur me njëri-tjetrin, janë mësuar të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, të tolerojnë, korrigjojnë njëri-tjetrin në një mënyrë më të butë dhe të pranueshme për ta duke e bërë me të lehtë përshtatjen e tyre në kopsht. Loja është mjet themelor që krijon mundësitë për hyrje në raporte mes të fëmijëve, është një mjet i domosdoshëm për çdo edukator përmes të cilit mund t'i arrinë qëllimet edukative dhe pedagogjike.

Përcaktimi ynë në hulumtimin e ndikimit të aktiviteteve kreative dhe lojërave sociale në përshtatjen e fëmijëve 3-4 vjeç dhe 5-6vjeç në kopsht ka ardhur si nevojë për të gjetur mënyra dhe metoda që do ndikojnë në përshtatje të fëmijëve në kopsht. Nga viti në vit ne kemi hartuar plane aktivitete në mënyrë që fëmijët të kenë më të lehtë kalimin e kësaj faze nga shtëpia në kopsht, dhe gjatë vëzhgimit dhe reflektimit të punës edukative së bashku me edukatoren e grupit tjetër kemi konstatuar se lojërat lëvizëse dhe aktivitetet kreative janë duke u pëlqyer më shumë fëmijëve dhe këto aktivitete po ndikojnë pozitivisht gjatë qëndrimit të fëmijëve në kopsht.



## AKTIVITETET KREATIVE dhe LOJËRAT SOCIALE

Në këtë hulumtim është shfrytëzuar metodologjia e hulumtimit në veprim, që ka për qëllim të përcaktojë ndikimin e aktiviteteve kreative dhe lojërave sociale në përshtatjen e fëmijëve të grupmoshës 3-4 dhe 5-6 vjeç në kopsht. Përmes metodologjisë së hulumtimit në veprim janë shfrytëzuar disa plane veprimi, si: Plani i veprimit në javën e parë është bërë përmes aktiviteteve kreative dhe lojërave sociale si: ngjyrosja e simbolit të grupit, vendosja e gjurmëve të fëmijëve, lojëra logjike me sajuese, me blloqe, etj. Plani i veprimit në javën e dytë është realizuar përmes aktiviteteve si: aktivitete psikomotorike, kërcimi me litar, dramatizim, muzikë, etj. Ndërsa në javën e tretë janë realizuar me lojëra në natyrë me rekuizita dhe lodra.

**PLANI I VEPRIMIT 1:**  
*Aktivite Kreative  
modelim me plastelinë,  
ngjyrosje, lojëra logjike  
me kube dhe blloqe.*

Në javën e parë janë realizuar aktivitete kreative dhe lojëra sociale në grup të fëmijëve me qëllim socializimi mes fëmijëve dhe lidhjen me grup. Po ashtu fëmijët kanë hulumtuar këndet edukative në dhomë duke përdoruar lodrat logjike të cilat kanë arritur t'i ndajnë me fëmijët tjerë, megjithëse për fëmijët është paksa e vështirë kjo gjë, ata nuk arrijnë ende të ndajnë lodrat me të tjerët pasi që është e shfaqur ndjenja egocentrike gjatë lojës që do të thotë secili dëshiron të luaj dhe ta ketë lodrën e tij të pëlqyer. Gjatë vëzhgimit të fëmijëve, është vërejtur se angazhimi i fëmijëve në lojëra sociale dhe creative, ndikon në qetësimin e tyre dhe përshtatjen e lehtë me kopshtin, gjatë zhvillimit të lojërave, fëmijët janë përqëndruar më gjatë në lojë, kanë përjetuar kënaqësi duke krijuar kështu miqësi dhe afërsi me njëri tjetrin. Mirëpo, jo të gjithë fëmijët kanë pranuar lehtë këto lojëra dhe aktivitete kreative, disa prej tyre kanë qëndruar jashtë grupit duke vëzhguar lojën apo luajtur individualisht.

## **PLANI I VEPRIMIT 2: *Aktivitetet psikomotorike, dramatizim, muzikë dhe vallëzim.***

Planifikimi i aktiviteteve dhe lojërave tjera është bërë duke pasur parasysh opinionet e prindërve dhe vëzhgimet që u realizuan gjatë kësaj kohe. Ne si edukatore, gjatë vëzhgimit kemi parë se, aktivitetet kreative dhe lojërat lëvizëse, janë duke u pëlyqer më shumë fëmijëve dhe gjatë kësaj kohe vëmendja e tyre është më e përqëndruar në kopsht, nuk qajnë dhe nuk i kërkojnë prindërit. Prandaj gjatë kësaj jave janë realizuar aktivitete si dramatizim me kukulla, lojëra simbolike si roli i nënës dhe bebes, treni niset në kopsht për të marrë fëmijët dhe lojërat psikomotorike që janë argëtuar shumë dhe i kanë qetësuar pothuajse çdo fëmijë, fëmijët janë lidhur më shumë emocionalisht me njëri-tjetrin.

## **PLAN I VEPRIMIT 3: *Aktivitete shoqërore në natyrë përmes lodrave dhe rekuizitave sportive.***

Aktivitetet kreative dhe disa lojëra shoqërore janë praktikuar edhe jashtë dhomës së fëmijëve me qëllim që të përforcohet përshtatja e fëmijës me të gjithë ambientin që do ta rrethojë në kopsht. Këto aktivitete janë zhvilluar në oborr të kopshtit përmes lodrave dhe rekuizitave sportive të cilat ndikuan jashtëzakonisht shumë në qetësimin e fëmijëve. Të gjithë fëmijët janë ndier të relaksuar, pa ndonjë pengesë kanë luajtur jashtë me njëri tjetrin, kanë hulumtuar vendin dhe kanë organizuar lojëra të lira.

Loja si metodologji e mirë nxënieje është përdorur edhe në procesin mësimor dhe ka rezultuar dhume efektive edhe për fëmijët me vështirësi në të nxënë duke bërë që të përvetësohen nga ata konceptet bazë, numrat nga 1-10, ngjyrat, shkronja dhe fjalë etj.

**ANILA TUSHI**

Mësuese: Kopshti “Liria” Shkodër

# RËNDËSIA E KUJDESIT SHËNDETËSOR NË FËMIJËRINË E HERSHME

Bazuar në studime të ndryshme, në Shqipëri, gjendja shëndetësore e romëve është më e keqe se ajo e popullsisë maxhoritare, e cila pasqyrohet edhe në jetëgjatësinë më të ulët. Shkaqet e gjendjes jo të mirë shëndetësore lidhen me varfërinë, kushtet e vështira të jetesës dhe mungesën e infrastrukturës bazë, mundësinë e kufizuar në shërbimet shëndetësore, nivelin e ulët arsimor dhe disa forma të diskriminimit. Fëmijët romë janë një nga grupet më të rrezikuara për sa i përket shëndetit, çka duket edhe në nivelet më të larta të vdekshmërisë foshnjore. Shëndeti i grave shtatzëna dhe i nënave të reja është një shqetësim tjetër i madh. Një pjesë e madhe e vajzave Rome bëhen nëna në moshë të hershme dhe cilësia e përkujdesjes ndaj fëmijëve është më e vogël se ajo e grave më të rritura. Niveli i ulët arsimor i grave/nënave romë është një faktor tjetër që ndikon negativisht në kujdesin shëndetësor të tyre dhe të fëmijëve. Shumë prej tyre nuk i përdorin shërbimet shëndetësore, sepse nuk janë të ndërgjegjshme që gjendja shëndetësore e tyre dhe e fëmijëve kërkon trajtim mjekësor.

Kujdesi Shëndetësor Parësor (KShP) aktualisht përdoret si referim kyç për shëndetin e popullsisë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e përkufizon shëndetin si “Gjendje e mirëqënies së plotë fizike, psikologjike dhe sociale dhe jo vetëm mungesë e sëmundjes apo e të qënit i pamundur”.

Një pjesë e rëndësishme e projektit “Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome në Shqipëri” është edhe shërbimi shëndetësor i ofruar për fëmijët në kopshte dhe nënat e tyre, në të katërta zonat e projektit: Korçë, Shkodër, Moravë-Berat dhe Baltëz-Fier. Shëndeti i fëmijëve frekuentues të kopshteve, kontrollohet në mënyrë periodike nga mjekët të cilët në të njëjtën kohë ofrojnë edhe konsulta të ndryshme për prindërit e fëmijëve, me qëllim parandalimin e sëmundjeve. Rastet e identifikuar të cilat nuk mund të mjekohen me menyra ambulatorë janë drejtuar për ekzaminime dhe kontrole me të specializuara.

Përveç konsultave individuale, trajnime në lidhje me tema të ndryshme për kujdesin ndaj shëndetit të fëmijës dhe nënës janë organizuar në secilin prej kopshteve. Trajnimet janë organizuar në formë bisedash që nënat të kuptojnë dhe të përvetësojnë sa më shumë informacion dhe njëkohësisht të shprehin eksperiencat e tyre. Këto trajnime kanë si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit ndërmjet antarëve të komunitetit Rom mbi rëndësinë që ka kujdesi shëndetësor dhe frekuentimi i qendrave shëndetësore. Vitet e para të jetës përbëjnë bazat e kapacitetit të mëvonshëm për të mësuar, të sjelljes në shoqëri, dhe personalitetit. Duke i ofruar kujdesin e mjaftueshëm, shëndetin e ushqimin e duhur, një fëmijë ka shumë gjasa që të jetë i suksesshëm në shkollë, të integrohet në komunitetin e tij, dhe të rritet si një qytetar i përgjegjshëm. Në të kundërt, vëmendja e pamjaftueshme në vitet e para të jetës mund të bëjë që një fëmijë ta ketë të vështirë të mësojë në shkollë, dhe të ketë vështirësi kur të rritet.

Botim i Unionit “Amaro-Drom” Nr. 2, Dhjetor 2016